

## Përdorimi dhe paraqitja e citimeve, referencave dhe bibliografisë

**Burimet** ndihmojnë për të gjetur materiale shtesë në marrëveshje me mendimin tuaj rreth temës. Ato mund të jenë:

1. Libra me një ose me më shumë se një autor;
2. Kapitull nga një tekst i edituar;
3. Disa publikime nga i njëjti autor;
4. Artikull në periodik (revistë, buletin etj.);
5. Burime nga interneti;
6. Studentët konkurrues do të përdorin jo më pak se 3 burime për faqe, ku platforma **JSTOR** do të shërbejë si burim i detyrueshëm. – **50% të detyrueshme nga JSTOR.**

### Mund të përdoren:

#### 1. Citimi i shkurtër

Citimet e një fjalie, ose më pak se katër rreshta, mund të përfshihen brenda trupit të tekstit dhe brenda thonjzave të dyfishta. **Për shembull:**

*Barnes thotë: "ka një numër hapash praktikë që mund të ndërmerren në mënyrë që të studioni në mënyrë efektive (1992: 5).*

#### 2. Citimi i gjatë

Citimet më të gjata përcaktohen veçmas, të theksuara nga kufijtë e majtë dhe të djathtë dhe me ndarje të vetme., në këtë rast nuk përdorni shënjes për citimet. **Për shembull:**

*Për shumë studentë studimi akademik në një nivel të caktuar është varrosur në mister. Në veçanti në nivelin e diplomimit mund të harxhohet kohë në përpjekje për të realizuar çfarë kërkon një pedagog nga ju për të arritur diplomimin (Barnes, 1992: 2).*

#### 3. Citim brenda një citimi tjetër

Gjithmonë duhet të përpiqeni të përdorni **referime të burimit original të referencës**. Në rastet e referencave të dorës së dytë, kur një autor citon punën e një tjetri dhe ju jeni në pamundësi për të konsultuar tekstin origjinal, fraza "cituat në" ose "cit. në" përdoret kur i referoheni tekstit tuaj. **Për shembull:** *Buzan (1974 cit. në Barnes, 1992) thotë se një përmbledhje e një leksioni është shpesh më i dobishëm se sa shënimet e zgjeruara.*

### Shenja që përdoren në citime

1. Tri pikat (...) të tregoni se ku keni lënë fjalën nga citimi, kur citimi nuk fillon apo mbaron ku fillon apo mbaron fjalia.
2. Kllapat katrore [] për të bashkëngjitur fjalë që keni shtuar në citimin e drejtpërdrejtë, sqarime, shënime apo përkthime të bëra nga ju.

### Paraqitja në tekst e referimeve bëhet duke u orientuar nga burimi dhe autori, sipas shembujve:

- Një libër ose një artikull nga një autor (në një gazetë a në një përmbledhje punimesh) në kllapambiemri i autorit , viti i publikimit **p.sh.** (Porter, 1980)
- Dy autorë : mbiemrat e të dy autorëve , viti i publikimit **p.sh.** (Hamel & Prahalad, 1994)
- Mbi dy autorë : Vetëm autori i parë i ndjekur nga shkurtimi et al. **p.sh.** (Berry et al., 1992)
- Disa burime nga i njëjti autor : mbiemri i autorit , viti i publikimit për secilin burim në rend kronologjik **p.sh.** (Tannen, 1993, 1994)

#### 4. Poshtëshënimet (Footnotes)

Poshtëshënimet mund të përdoren për komente anësore, d.m.th. materiale jashtë drejtimit të rreshtit kryesor, argumentimit në tekst apo për formulimin e citimeve të përkthyer. Ato duhet të paraqiten në fund të faqes me një madhësi më të vogël se madhësia e tekstit bazë (10 pt), me një hapësirë. Numri i shënimit vendoset menjëherë pas idesë, fjalës ose fjalisë me të cilën do të lidhet poshtëshënimi.

#### *Ja dhe disa burime me shembuj orientues të paraqitjes së tyre në listën e referencave :*

- *Libra*

Mbiemri, Nisoret e emrit. (viti i publikimit). Titulli: nëntitulli. vendi i botimit: botuesi.

Lewis, R. (2000). When cultures collide: managing successfully across cultures. London: Nicholas Brealey Publishing.

- *Kapitull nga një tekst i edituar*

Mbiemri, Nisoret e emrit. & Mbiemri, Nisoret e emrit. (viti i botimit). Titulli i kapitullit. në botim (eds.) Titulli i librit (nr.i faqeve të kapitullit). Vendi i botimit: botuesi.

O'Neil, J. M , & Egan, J. (1992). Men's and women's gender role journeys: A metaphor for healing, transition, and transformation. In B. R. Wainrib (Ed.), Gender issues across the life cycle (pp. 107-123). Neë York, NY: Springer.

- *Disa publikime nga i njëjti autor*

Nëse ka më shumë se një publikim në të njëjtin vit, viti i botimit shenjohe me a,b,c etj., nga më i hershmi te më i riu:

Sinha, J. B. P. (1984a). A model of effective leadership styles in India. International Studies of Management and organization, 14, 86-98.

Sinha, J. B. P. (1984b). Towards partnership for relevant research in the Third World. International Journal of Psychology, 19, 169-177.

- *Artikull në periodik (revistë, buletin etj.)*

Autor, A. A. (viti i botimit). Titulli i artikullit. Titulli i periodikut, volumni, numri, faqet.

Harlow, H. F. (1983). Fundamentals for preparing psychology journal articles. Journal of Comparative and Physiological Psychology, 55, 893-896.



Berns, M. (1993). Art, History, and Gender: Women and Clay in West Africa. *The African Archaeological Review*, 11, 129-148. Retrieved April 22, 2021, from <http://www.jstor.org/stable/25130562>

Chattopadhyay, R., & Duflo, E. (2004). Women as Policy Makers: Evidence from a Randomized Policy Experiment in India. *Econometrica*, 72(5), 1409-1443. Retrieved April 22, 2021, from <http://www.jstor.org/stable/3598894>

Gundert, S., & Mayer, K. (2012). Gender Segregation in Training and Social Mobility of Women in West Germany. *European Sociological Review*, 28(1), 59-81. Retrieved April 22, 2021, from <http://www.jstor.org/stable/41343470>

Karlekar, M. (1998). Domestic Violence. *Economic and Political Weekly*, 33(27), 1741-1751. Retrieved April 22, 2021, from <http://www.jstor.org/stable/4406963>

Pedraza, S. (1991). Women and Migration: The Social Consequences of Gender. *Annual Review of Sociology*, 17, 303-325. Retrieved April 22, 2021, from <http://www.jstor.org/stable/2083345>

Snyder, R. (2008). What Is Third-Wave Feminism? A New Directions Essay. *Signs*, 34(1), 175-196. doi:10.1086/588436

Sudarkasa, N. (1986). "The Status of Women" in Indigenous African Societies. *Feminist Studies*, 12(1), 91-103. doi:10.2307/3177985

**Shënim: Duhet respektuar edhe vendosja e shenjave të pikësimit sipas shembujve ilustrues.**

Platforma **JSTOR** mundëson citimin e të gjithë referencave në tre formate të ndryshme. Në varësi të interesit të aplikantëve, do të organizohen edhe trajnime online për rregullat e shkrimit akademik. Për t'u bërë pjesë na shkruani në:

[JSTOR@CleanScore.al](mailto:JSTOR@CleanScore.al)